



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2020, miratoi këtë

V E N D I M

P Ë R

**MIRATIMIN E NDARJES SË SUBVENCIONIMIT PËR TRANSPORTIMIN E
DONACIONIT NË MALLRA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e subvencionimit për transportimin e donacionit në mallra për personat me aftësi të kufizuara.

II.

Ndarja e subvencionimit për donacionin e cekur në pikën I të këtij Vendimi, është në shumën 5,300,00 €, shumë kjo e siguruar nga programi i subvencioneve nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale.

III.

Mjetet e cekura në pikën II të këtij vendimi, do të barten në xhirollogarinë e OJQ- së “Fehmi Agani” me këto të dhëna: KOSOVO ALBANSK FORENING, Nr. i xhirollogarisë: 28001076096, IBAN: N02628001076096, Sparebanken Sor, PostBoks200, 4662 KristianSand, ËIFT (BIC): SPS0N0022.

IV.

Qëllimi i ndarjes së mjeteve të cekura si në pikën II të këtij vendimi, është mbulimi i shpenzimeve të transportit të pajisjeve të donacionit për personat me aftësi të kufizuara.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Financave .

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-450/01-59691/20, më 12.03.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

Faqe 1 nga 2



Arsyetim

Duke pasur parasysh nevojat dhe kërkesat e jashtëzakonshme që i drejtohen Drejtorisë së Mirëqenies Sociale për pajisjen me mjete të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, gjithashtu në suaza të ngritjes dhe përmisimit të mirëqenies së qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Komuna e Prishtinës, respektivisht Drejtoria për Mirëqenie Sociale si përfituese e donacionit nga Donatori-Sponsorizuesi Albanin Union "Fehmi Agani" me adresë Nye stenklevei 26, 4846 Arendal, Norvegji, me përfaqësues Gjevdet Kelmendi, jemi dakorduar për pranimin e donacionit, pajisje teknike dhe mobile për personat me aftësi të kufizuara dhe veshëmbathje dedikuar personave në nevojë, në komunën e Prishtinës.

Në bazë të këtij donacioni të fituar, Komuna e Prishtinës ka pranuar një sasi të konsiderueshme të të mirave materiale, konkretisht 10330 (dhjetëmijë e treqind e tridhjetë) kilogram pajisje, me vlerë 246,450.00 kruna norvegjeze.